

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fjalimi në OKB/ Këllici: Rama akuzoi shqiptarët për antisemitizëm - do mbahet mend se ktheu Shqipërinë në narkoshtet
ADRESA	https://piranjat.al/politike/fjalimi-ne-okb-kellici-rama-akuzoi-shqiptaret-per-antisemitizem-do-mbah-i106291
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 11:59:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 11:56:43 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b99195224cf7fce05f8187ece066e8f52b900d72972a5909094924a07ddfd9c2
TEKSTI	d0898d769b1f89577d7ec0db5ca0da44a27026a454a97db06aaee7255bea351
PAMJA	c22e86f4eb7d49d9b9a5b0f9ab9f7c7a44d93cf691d9fdec6f04dba73743f681

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	63c830d4848e95f21ff7651fd24488101799c814c9c72434344565dc904ac726
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7677d8d9488aa5a9422459265187ef4d7802fbf31e13dbd8fed410ad19a65ead
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/63c830d4848e95f21ff7651fd24488101799c814c9c72434344565dc904ac726>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: [mjeket neurologë](#) në gjendje të lirë, ndërta ■ [Çështja është në](#) Edi Rama me institucionet e Dre ■ ["Pitbulli" që del në](#) është një prej personave ■ [Interpol Manchester](#) në flet pasi nga verifikimet e policisë ■ [gratë me diferencë](#) për vitin 2025 tregojnë se ■ [foto ngji](#)

[POLITIKE](#)

Fjalimi në OKB/ Këllici: Rama akuzoi shqiptarët për antisemitizëm - do mbahet mend se ktheu Shqipërinë në narkoshtet

Nga Belind Këllici Përditësimi i fundit 27 Shtator 2026, 13:56



Miq të e mi,

Ju ftoj të ndiqni një pjesë të fjalimit të Edi Ramës në OKB.

Këtë fjalë zgjodhi Edi Rama të marrë me vete në OKB nga protesta e shqiptarëve kundër qeverisë së tij kriminale. E bëri në emër të një populli që ka një nga historitë më të jashtëzakonshme të besës në Europë, atë me hebrejtë gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Në kohën kur Europa i dorëzonte hebrejtë të nazistët, shqiptarët i strehonin bujarisht në shtëpi me rrezikun mbi krye. U jepnin emra shqiptarë, dokumente, bukë, çati dhe mbi të gjitha, mbrojtje. Shqipëria doli nga Lufta e Dytë Botërore me më shumë hebrej sesa kishte në fillim të saj.

Tetëdhjetë vjet më vonë, kryeministri i tyre nuk eksportoi nga Shqipëria në OKB këtë testament moral e fisnik, por plas publikisht syshqyer përdorimin e njëres prej fjalëve më të rënda të historisë njerëzore si kundërpeshë ndaj një revolte që kërkon prej 120 ditësh largimin e tij.

Tmerri i Holokaustit nuk mund të përdoret kaq pafytyrësisht nga departamenti i komunikimit të Kryeministrit për të çfokusuar vëmendjen nga skandalet e narkoshtetit të vetëm në Europë, baba themelues i të cilit është vetë Edi Rama.

I damkosur, por pa cipë, nga foltorja e OKB-së i shpjegonte botës se si prodhohet manipulimi me Inteligjencë Artificiale, si ngarkohet me emocione, personalizohet, shumëfishohet dhe, në fund paketohet si realitet. Dhe mizorisht për ta shitur këtë mall që e njeht mirë, akuzoi publikisht popullin e tij. E padëgjuar më parë. Nuk ka guxuar ta bëjë këtë asnjë kryeministër në Europë, madje as nga vende ku ka popullsi emigrante dhe të integruar me ndjenja të theksuara anti izraelite.

Shqiptarët nuk kanë nevojë t'i japin askujt certifikatë pafajësie për antisemitizëm. Ama kryeministri duhet t'u përgjigjet shqiptarëve së pari se çfarë halli madhor po e detyron të lidhë Revolucionin e Flamingove, një protestë qytetare që lindi nga kundërshtimi ndaj një projekti në Zvërnec dhe u zgjerua në një revoltë kundër narko qeverisjes së tij me teza të rrezikshme antisemitizmi.

Kryeministri duhet t'u përgjigjet sidomos shqiptarëve edhe për një episod të pazbardhur.

Gjatë protestave, një vajzë e maskuar hoqi dhe grisi një flamur izraelit pranë Ambasadës së Izraelit. Por më pas vajza u zhduk nga historia.

A u mor në pyetje? A kishte lidhje me protestuesit? A veproi e vetme?

Meqë kryeministri “u mundua” gjer në OKB të fajësonte popullin e tij për antisemitizëm, pse nuk e shndërroi në proces madhor brenda vendit këtë çështje gjer në zbardhjen e plotë të saj?

Ka Policinë e Shtetit, struktura hetimore, shërbime inteligjence, ka kamera kudo, të infiltruar, sistem sigurie rreth përfaqësive diplomatike. Pse nuk ia dogji shpirtin kjo shprehje flagrante antisemite? Pse nuk e zbuloi kurrë shteti i tij se kush ishte kjo vajzë që tentoi të ushqejë narrativën që vetë Rama përdori në foltoren e OKB-së?

Sa karagjoz ngjan kur pretendon se ka kuptuar mekanizmin e një operacioni kompleks të manipulimit digjital, mënyrën se si algoritmet depërtuan në “botët emocionale” të qytetarëve dhe transformuan një gënjeshtër në realitet politik, por identitetin e një vajze përpara një ambasadë rrethuar me qindra kamera, polici, agjentë nuk e dimë ende! Ja pse sot ngjan edhe më i mjerë e i përmjerë teksa përpëlitesh duke përdorur reputacionin moral të popullit si mburojë politike për namin e zi të pushtetit tënd të diskretituar ndërkombëtarisht.

Edi Rama do të mbahet mënd gjatë në memorien tonë si Kryeministri që kriminalizoi ekonominë, shpopulloi vendin, vrau arsimin, transformoi spitalet në kampe përqëndimi. Ndërsa në historinë e këtij vendi do të mbetet se shqiptarët, në orën më të errët të Europës, u hapën derën hebrenjve kur kjo mund t’u kushtonte jetën. Ndërsa Rama do të mbahet mend si kryeministri që shndërroi Shqipërinë në narkoshtet e për të shpëtuar pushtetin e tij, guxoi ndrysisht t’i linte një populli të tërë njollën e antisemitizmit.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 27 Shtator13:50

[Stadiumi jehoi me thirrje kundër Ramës, Bardhi: Në Shqipëri, diasporë, sheshe e shkolla ka vetëm një thirrje, shporru!](#)

Fitorja e Shqipërisë ndaj Bjellorusisë solli jo vetëm entuziazëm dhe gëzim te tifozët, por u përcollën edhe mesaz...

POLITIKE 27 Shtator10:31

[Ish zv.ministri i Arsimit: Rama nuk u pranua në takimet e nivelit të lartë në New York](#)

Ish-zv.ministri i Arsimit, Oltion Rrumbullaku ka komentuar qëndrimin e kryeministrit Edi Rama në Nju Jork, gjatë zhvillimit të punimeve t&...

POLITIKE 26 Shtator21:54

[Kush e përzgjedhi dhe verifikoi Vlora Hysenin? Ish-ministrja socialiste, Meksi, reagon për skandalin e SHISH](#)

Ish-ministrja dhe ish-deputetja Ermelinda Meksi ka reaguuar përmes një postimi në Facebook lidhur me çështjen e Vlora Hysenit. Meksi ...

POLITIKE 26 Shtator21:47

[Thirrja “urgjente”/ Rama mesazh shqiptareve nga Rinasia pas kthimit nga SHBA, zbardhen detajet](#)

Nesër sapo të kthehet nga vizita në Kombet e Bashkuara, kryeministri Edi Rama do t’u drejtohet me një mesazh shqiptarëve nga sall...

POLITIKE 26 Shtator21:15

[Nga vezët e protestuesve te torta me flamingo, Rama batuta para diasporës në Nju-Jork](#)

Kryeministri Edi Rama, gjatë takimit me diasporën shqiptare në Nju-Jork, foli për një ndryshim në marrëdhënien mes ...

POLITIKE 26 Shtator19:48

[“Brenda SPAK ka përplasje për Vlora Hysenin”. gazetari: Ai dhe një gjyqtar i GJKKO ka qenë në zyrën e Ergys Agasit](#)

Prokurori i dosjes së AKSHI-t, Altin Dumani është në një konflikt me një prokuror të SPAK për llogari të dosjes s&e...

POLITIKE 26 Shtator19:01

[“Nis mbledhja e firmave për referendum për bashki”/ Zhupa nga Ksamili: Kërkojmë të respektohet vullneti dhe nevojat e qytetarëve](#)

Drejtuësja politike e Partisë Demokratike për rrethin e Sarandës, deputetja Ina Zhupa, ka bërë të ditur nisjen e mbledhjes së...

POLITIKE 26 Shtator18:41

[Aktivistja ‘masakron’ deputetin: Erion Braçe o karton, ça thotë shefi ti voton](#)

Aktivistja Arvina Lleshi ka ‘shenjësraur’ sërish deputetin e PS, Erion Braçe, teksa tanimë socialistët janë v&eum...

POLITIKE 26 Shtator17:33

[‘Disa histori i kam jetuar, ka shumë për të thënë’/ Çfarë po paralajmëron ish-ministri Tahiri? Publikon videon ‘enigmatike’](#)

Ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri, ka surprizuar me postimin e tij të fundit në rrjetet sociale. Në postimin e tij, Tahiri shkruan:...

POLITIKE 26 Shtator17:17

[“As Netflix s’do ta imagjinonte. Skenar apokaliptik”/ Artan Hoxha për skandalin e Vlora Hysenit: Kjo që ndodhi me SHISH-in nuk do ta arrinte as një shërbim armik](#)

Gazetari Artan Hoxha ka komentuar në emisionin “Kjo Javë” në News24, me gazetaren Nisida Tufa, arrestimin e ish-drejtores së SHI...

ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 26 Shtator

[Thirrja “urgjente”/ Rama mesazh shqiptareve nga...](#)

Nesër sapo të kthehet nga vizita në Kombet e Bashkuara, kryeministri Edi Rama do t’u drejtohet me një mesazh shqiptarëve nga sall...

AKTUALITET 26 Shtator

[Autobusi përfshihet nga flakët në hyrje të tune...](#)

Një autobus është përfshirë nga flakët në hyrje të tunelit në Elbasan. Për shkak të incidentit, rruga &e...

AKTUALITET 26 Shtator

[Mbyllen hetimet për vrasjen e gjyqtarit Astrit ...](#)

Prokuroria e Tiranës i ka komunikuar sot Elvis Shkambit akuzën për “vrasje të funksionarëve publikë për shkak të d...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

[Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

video



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.